



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2803 Prot.

Lezhë, më 02 . 03 . 2026

VENDIM

Nr. 19, Datë 25. 02. 2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2026-2030**

Në mbështetje të ligjit Nr. 8417., datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji Nr. 119/2015 “Për të drejtën e informimit”, ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKM Nr. 88, datë 22.02.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian 2022-2030”, VKM Nr. 271, datë 02.05.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024-2026”, VKM Nr. 173, datë 24.03.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030”, VKM Nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikë 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Nr. 2808/1 - prot
Dt: 11.3.2026



K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 212/12 Prot.

Lezhë, më 10.03.2026

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16, pika 2/b, të ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në ligjin nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", VKM-në nr.88, datë 22.02.2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian 2022-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024-2026" i ndryshuar, VKM nr.621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit të këshillit të bashkisë Lezhë, nr.19, datë 25.02.2026, "Për miratimin e planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2026-2030".

PREFEKTI

Taulant MALSHI

